



UNIVERSITETI I SHKODRËS

“Luigj Gurakuqi”

SENATI

Nr. 2883 prot.

Shkodër, më 15. 08. 2016

V E N D I M

nr. 340, datë 15. 08. 2016

“PËR MIRATIMIN E TARIFËS SË KONKURSEVE NË PROGRAMET E CIKLIT TË PARË TË STUDIMEVE (BACHELOR), SISTEMI ME KOHË TË PLOTË, VITI AKADEMIK 2016-2017”

Në mbështetje të Ligjit nr.80, dt.22.07.2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”, udhëzimit të MAS nr.13, datë 22.07.2016 “Për procedurat e aplikimit dhe të regjistrimit në programet e ciklit të parë të studimeve, me karakter profesional, si dhe në programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë, me kohë të plotë, në institucionet e arsimit të lartë, për vitin akademik 2016-2017” dhe sipas propozimit të Fakultetit të Shkencave të Edukimit (vendimi i FSHE nr.8, dt.29.07.2016), Senati Akademik i Universitetit të Shkodrës” Luigj Gurakuqi” në mbledhjen e tij të datës 15.08.2016 :

VENDOSI

1. Të miratojë tarifën e konkurseve në programet e ciklit të parë të studimeve (bachelor), sistemi me kohë të plotë, viti akademik 2016-2017”
 - Në programin e ciklit të parë bachelor në degën “Edukim fizik dhe sporte” tarifa e konkursit 5.000lekë
 - Në programin e ciklit të parë bachelor në degën “Pedagogji muzikore” tarifa e konkursit 5.000lekë
 - Në programin e ciklit të parë bachelor në degën “Pikturë Grafikë” tarifa e konkursit 5.000lekë
2. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.



Kryetari i Senatit Akademik

Prof.dr. Adem BEKTESHI